



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 622/3 Prot.

Durrës, më 11.4.2023

VENDIM
Nr. 21, datë 11.4 2023

PËR
"MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT NËN MASËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT PROFESIONAL 2-VJEÇAR "EDUKATOR PËR MOSHËN 0-3 VJEÇARE", PRANË QENDRËS SË EDUKIMIT NË VAZHDIM, NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në shkresën Nr.467 Prot., datë 09.03.2023 të Fakultetit të Edukimit, në relacionin Nr.518 Prot., datë 23.03.2023 të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Për miratimin e riorganizimit nën masën 20% të programit të studimit profesional 2-vjeçar "Edukator për moshën 0-3 vjeçare", pranë Qendrës së Edukimit në Vazhdim, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Zv. Rektorët
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Edukimit
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Bazë pranë Qendrës së Edukimit në Vazhdim
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2023-2024.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksenela **SOTIROFSKI**

